



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 5-4-2023
Nr. Prot 3481

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së KOMISIONIT RREGULLATOR

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni, se është përgatitur:

1. Projektvendimi "Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore".

Miratimi i këtij projektvendimi është kompetencë e Komisionit Rregullator.

Për këtë arsye propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtij projektvendimi.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimit dhe relacionin shoqërues.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



